



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"ILIASAN PRISHTINA"



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



UNIVERSITETI I MITROVICËS
ISA BOLETINI



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"KADRI ZEKA"



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
FEHMIAGANI



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Deklaratë nga Konferenca e Rektoreve e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës

4 shkurt 2019

Në takimin e sotëm të Konferencës së Rektoreve u shqyrtua gjendja në universitetet publike në Kosovë, pas njoftimit të AKA-së për mbylljen e programeve studimore të akredituara.

Pas takimeve me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, me zv/kryeministrin e Kosovës, z. Fatmir Limaj dhe me Komisionin Parlamentar për Arsim, Konferenca e Rektoreve e vlerëson përkushtimin e tyre për gjetjen e zgjidhjes në lidhje me njoftimin e AKA-së për mbylljen e programeve të akredituara.

Konferenca e Rektoreve beson se reagimi i saj ka rikthyer në opinion publik çështjen e autonomisë së universiteteve, e sulmuar viteve të fundit si nga grupet e interesit politik, si dhe ka shtuar besimin e profesoratit e të studentëve për ruajtjen e sistemit të lartë publik arsimor nga degradimi.






Konferenca e Rektoreve pajtohet me idenë e diskutuar në takime me institucionet Republikës së Kosovës për rishqyrtimin e strategjinë për zhvillimin e arsimit të lartë publik në Kosovë.

Konferenca e Rektoreve beson se studentët nuk duhet të pësojnë në këtë angazhim për arsimin e lartë publik dhe autonominë universitare. Provimet e afatit të janarit dhe semestri i dytë do të fillojnë në secilin universitet publik sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në kohën e duhur.

Universitetet publike qëndrojnë në kërkesat e artikuluara në takimin e 28 janarit 2019.

Universitetet publike do të organizojnë protesta në forma të ndryshme deri në realizimin e kërkesave.

Ftojmë institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërmarrin hapa konkretë në zgjidhjen e problemeve rreth mbylljes së programeve të akredituara.

1. Prof. dr. Fadil Millaku, rektori i UHZ-Pejë dhe zv. Kryesues 
2. Prof. dr. Marjan Dema, rektor i Universiteti të Prishtinës 
3. Prof. dr. Alush Musaj, rektori i UIMB-Mitrovicë 
4. Prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, rektori i UKZ-Gjilan 
5. Prof. dr. Shaban Buza, rektori i UGJFA-Gjakovë 
6. Prof. dr. Agron Bajraktari, rektori i USHA-Ferizaj 